



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe
Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 8 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Njoftimit të Rregullës 102(3)

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji) dhe të rregullave 9(5)(a), 82(5), 95(2)(b) dhe 102(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndër të tjera, urdhëroi që Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të paraqesë një njoftim të hollësishëm për provat sipas rregullës 102(3) të Rregullores (“Njoftimi”) deri të premten, 30 prill 2021.²
2. Më 24 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia zgjati afatin ZPS-së për të njoftuar Mbrojtjen deri të premten, 25 qershor 2021.³
3. Më 24 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia zgjati afatin ZPS-së për dorëzimin e njoftimit deri të premten, 30 korrik 2021, dhe rrjedhimisht ia zgjati afatin dhe Mbrojtjes për të kërkuar materiale sipas rregullës 102(3) deri të premten 24 shtator 2021 (“Vendim mbi Zgjatjen e Afatit”).⁴
4. Më 31 korrik 2021, ZPS-ja dorëzoi Njoftimin.⁵

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të lidhura me Të* (“Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave”), 23 nëntor 2020, publik, para. 99(f).

³ KSC-BC-2020-06, Transkripti i Seancës, 24 mars 2021, publik, f. 390, rreshti 17 deri në f. 391, rreshti 10.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 24 qershor 2021, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00421, Prokurori i Specializuar, *Njoftimi i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, me Shtojcën konfidenciale 1 (“F00421/A01”) dhe Shtojcën 2 rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, 31 korrik 2021, publik. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se parashtrimi u dorëzua më 31 korrik 2021 në orën 13:00, pra, vetëm një orë pas afatit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e pranoi parashtrimin e ZPS-së duke marrë parasysh vonesën e papërfillshme.

5. Më 5 gusht 2021, Kadri Veseli ("Z. Veseli") dorëzoi një kërkesë për një ndryshim në Njoftim ("Kërkesa e Veselit"),⁶ pas një shkëmbimi të pasuksesshëm *inter partes* me ZPS-në.⁷ Të dy, Jakup Krasniqi ("Z. Krasniqi") dhe Hashim Thaçi ("Z. Thaçi") iu bashkuan Kërkesës së Veselit (përkatësisht, "Kërkesa për Bashkim e Krasniqit"⁸ dhe "Kërkesa për Bashkim e Thaçit"⁹). Kërkesa e Veselit, Kërkesa për Bashkim e Krasniqit dhe Kërkesa për Bashkim e Thaçit bashkërisht do të përmenden si "Kërkesa e Mbrojtjes".

6. Më 16 gusht 2021, ZPS-ja iu përgjigj Kërkesës së Mbrojtjes ("Përgjigjja").¹⁰ Z. Veseli dhe Z. Krasniqi u kundërpërgjigjën, përkatësisht më 17 gusht 2021 ("Kundërpërgjigjja e Veselit")¹¹ dhe më 23 gusht 2021 ("Kundërpërgjigjja e Krasniqit").¹²

II. PARASHTRIME

7. Z. Veseli, z. Krasniqi dhe z. Thaçi (bashkërisht, "Mbrojtja") parashtrojnë se ZPS-nuk e ka përmbushur kushtin për të dhënë një njoftim të hollësishëm sipas rregullës 102(3) të Rregullores. Në veçanti, ata argumentojnë se shumë prej materialeve që përmban Njoftimi janë përshkruar në mënyrë jo të mjaftueshme dhe

⁶ KSC-BC-2020-06, F00424, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshimin e Njoftimit të Rregullës 102(3)*, 5 gusht 2021, publik. Një version i korigjuar u dorëzua më 9 gusht 2021, F00424/COR.

⁷ Kërkesa e Veselit, para. 6-7.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00425, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Kërkesë për Bashkim e Mbrojtjes së Krasniqit me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Njoftimit të Rregullës 102(3)*, 6 gusht 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë dhe u njoftua më 9 gusht 2021, F00425/RED.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00431, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë për Bashkim e Mbrojtjes së Thaçit me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për ndryshimin e Njoftimit, sipas rregullës 102(3)*, 11 gusht 2021, konfidencial.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00433, Prokurori i Specializuar, *Përgjigjja e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për ndryshimin e Njoftimit sipas rregullës 102(3)*, 16 gusht 2021, publik.

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00435, Mbrojtja e z. Veseli, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Përgjigjes së ZPS-së, KSC-BC-2020-06/F00433 (Kërkesë për Ndryshimin e Njoftimit të Rregullës 102(3))*, 17 gusht 2021, publik.

¹² KSC-BC-2020-06, F00437, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Njoftimit të Rregullës 102(3)*, 23 gusht 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë dhe u njoftua më 24 gusht 2021, F00437/RED.

nuk i japin asnjë të dhënë Mbrojtjes për rëndësinë e tyre për çështjen, me qëllim që ajo të vlerësojë rëndësinë e tyre materiale për përgatitjet e saj.¹³ Si shembull, z. Krasniqi i referohet përmendjes së transkripteve të dëshmitarëve të ndryshëm me pseudonime dhe pa dhënë informacion lidhur me përmbajtjen e provave, gjë që nuk e lejon Mbrojtjen të vlerësojë nëse provat në fjalë mund të jenë me rëndësi materiale për përgatitjet e saj.¹⁴ Duke kujtuar se ZPS-ja ka detyrimin e përcaktimit të rëndësisë së materialeve për çështjen, Mbrojtja argumenton se vlerësimi i rëndësisë materiale të dokumenteve që përmban Njoftimi të cilin duhet ta bëjë ajo, nuk mund të kryhet në mënyrë efikase nëse Njoftimit i mungon konkretësia.¹⁵ Së fundi, ata parashtrojnë se mosdhënia nga ZPS-ja e hollësive lidhur me rëndësinë e një dokumenti për çështjen shkel parimin e drejtësisë dhe barazisë së palëve.¹⁶ Për rrjedhojë, ata i kërkojnë Gjykatësit të Procedurës Paraprake ta udhëzojë ZPS-në të ndryshojë Njoftimin e saj, duke shtuar një fushë e cila do të shpjegojë me hollësi “vlerësimin fillestar” të ZPS-së lidhur me rëndësinë për çështjen të çdo dokumenti të renditur në të.¹⁷

8. ZPS-a përgjigjet se, duke pasur parasysh kompetencën e kufizuar diskrecionale të saj për të vepruar lidhur me Njoftimin, do të ishte e kotë dhe pa vend të shpjegohej rëndësia e perceptuar e dokumenteve që përfshin ai për çështjen.¹⁸ ZPS-ja argumenton më tej se rëndësia e disa dokumenteve mund të nënkuptohet nga lidhja e tyre kohore, gjeografike apo nga lidhje të ngjashme me akuzat dhe se ajo e ka dhënë një informacion të tillë në përshkrimet e dokumenteve.¹⁹ Gjithsesi, ZPS-ja parashton se ndërkohë ajo ka marrë përsipër rishikimin e Njoftimit, në veçanti, përdorimin e pseudonimeve, për të trajtuar shqetësimet e Mbrojtjes lidhur me disa dokumente.²⁰

¹³ Kërkesa e Veselit, para. 6, 14-15; Kërkesa për Bashkim e Krasniqit, para. 9-10; Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 10-12, 15.

¹⁴ Kërkesa për Bashkim e Krasniqit, para. 9. *Po ashtu*, Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 12.

¹⁵ Kërkesa e Veselit, para. 10-11.

¹⁶ Kërkesa e Veselit, para. 16.

¹⁷ Kërkesa e Veselit, para. 1, 15, 17; Kërkesa për Bashkim e Krasniqit, para. 2, 9, 12; Kërkesa për Bashkim i Thaçit, para. 4, 16.

¹⁸ Përgjigja, para. 5-7.

¹⁹ Përgjigja, para. 9.

²⁰ Përgjigja, para. 10.

9. Në Kundërpërgjigjen e tij, z. Veseli thekson se Njoftimi duhet të japë të dhëna të hollësishme për arsyen se përse dokumentet që gjenden në të janë me rëndësi për çështjen, pra, duke përmendur në veçanti se si një dokument është “në favor apo kundër” z. Veseli.²¹ Më tej, ai parashtron se ZPS-ja ka pasur kohë të përgatiste një listë të hollësishme dhe se ZPS-ja duhet të mbahet përgjegjëse për çdo vonesë që rrjedh nga ky proces.²² Z. Krasniqi thekson se Njoftimi nuk është shumë i hollësishëm dhe se nuk mund të pritët që Mbrojtja të diskutojë *inter partes* përshtatshmërinë e informacionit voluminoz brenda afatit aktual.²³ Ai sqaron se çështja ka të bëjë me shkallën e hollësive të dhëna në Njoftim dhe kujton se Mbrojtja duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për vlerësimin e rëndësisë materiale të të gjitha dokumenteve.²⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Sipas nenit 39(13) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mundet, sipas rastit, me kërkesën e një pale apo të Mbrojtësit të Viktimave, ose kërkesë të vet, të nxjerrë një urdhër tjetër, sipas nevojës, për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

11. Në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, Prokurori i Specializuar, sipas nenit 21(6) të Ligjit, i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim të tij.

12. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, trupi gjykues, *proprio motu* ose pasi t'i paraqiten arsye të vlefshme, mund ta zgjasë apo shkurtojë afatin e përcaktuar nga Rregullorja apo të vendosur nga trupi gjykues.

13. Sipas rregullës 95(2)(b) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos, ndër të tjera, afate për nxjerrjen e materialeve dhe merr masa për të siguruar nxjerrjen në kohë të tyre.

²¹ Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 2-4, 8.

²² Kundërpërgjigjja e Veselit, para. 7.

²³ Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 3-4.

²⁴ Kundërpërgjigjja e Krasniqit, para. 6-7, 9-10.

14. Sipas rregullës 82(5) të Rregullores, trupi gjykues mund ta riklasifikojë një parashtrim *proprio motu*, kur nuk ekzistojnë më arsytet për atë klasifikim.

IV. ÇËSHTJE PARAPRAKE

15. Duke pasur parasysh karakterin themelor të çështjeve të ngritura në Kërkesën e Veselit, Mbrojtja kërkon që të mbahet një seancë urgjente.²⁵ ZPS-ja përgjigjet se kërkesa për një seancë me gojë duhet të hidhet poshtë, sepse palët kanë pasur mundësi të paraqisnin parashtrimet e tyre dhe se nuk është parashtruar asnjë arsye tjetër veç karakterit themelor të çështjeve.²⁶

16. Në dritën e parashtrimeve shteruese me shkrim të paraqitura nga palët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e gjykon të nevojshme të mbajë një seancë me gojë për këtë çështje.

V. DISKUTIM

17. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se është plotësisht në dijeni të vështirësive të procesit të nxjerrjes *inter partes*²⁷ dhe të përpjekjeve që duhen bërë nga palët e përfshira në të. Palëve u bëhet thirrje të vazhdojnë të bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive në përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve *inter partes*, sa herë që është e mundur. Në rast mosmarrëveshjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të ndërmjetësojë.

18. Nxjerrja e materialit sipas rregullës 102(3) të Rregullores, përbëhet nga një proces me tre hapa.²⁸ Si hap i parë, ZPS-ja jep njoftim të hollësishëm për “çdo

²⁵ Kërkesa e Veselit, para. 2, 18; Kërkesa për Bashkim e Krasniqit, para. 2, 12; Kërkesa për Bashkim e Thaçit, para. 4, 16.

²⁶ Përgjigja, para. 11.

²⁷ Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave, para. 46, 47.

²⁸ KSC-BC-2020-07, IA005/F00008/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit mbi Nxjerrjen e Provave* (Vendim mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Provave), 29 korrik 2021, publik, para. 38, që konfirmon interpretimin nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në të njëjtën lëndë, F00172/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi*

material dhe provë që ka në zotërim". Njoftimi i hollësishëm duhet të përfshijë çdo material dhe provë në zotërim të ZPS-së që është "me rëndësi për çështjen".²⁹ Ky hap i parë i procesit të nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(3) është i nevojshëm me qëllim që Mbrojtja të mund të vlerësojë atë që është thelbësore për përgatitjen e vet.³⁰

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Rregullorja nuk përcakton se deri në çfarë shkalle Njoftimi i ZPS-së duhet të jetë "i hollësishëm". Ndonëse është e vërtetë, sikundër parashtron ZPS-ja, se Gjykata e Apelit ka konfirmuar se ZPS-ja ka pak liri veprimi në përpilimin e Njoftimit sipas rregullës 102(3),³¹ ZPS-ja ka detyrimin t'i japë Mbrojtjes një njoftim të "hollësishëm". Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se një kërkesë e tillë nënkupton që Mbrojtja duhet të jetë në gjendje që më e pakta dhe në terma të përgjithshme, të jetë në gjendje ta lidhë një dokument me të akuzuarin ose me kontekstin e kryerjes së një vepre penale, apo të kuptojë kontekstin e tij. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se megjithëse, sikundër parashtron ZPS-ja, në disa raste lidhjet kohore, gjeografike apo lidhje të tjera me akuzat mund të mjaftojnë, në mungesë të ndonjë përshkrimi tjetër lidhur me kontekstin, data e një dokumenti, për shembull, jo gjithnjë mund t'i mundësojë Mbrojtjes të vlerësojë rëndësinë materiale që dokumenti në fjalë ka për përgatitjen e saj. Së fundi, sipas formulimit të rregullës 102(3) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ZPS- nuk është e detyruar të shpjegojë rëndësinë e çdo dokumenti provues, por duhet të japë përshkrime mjaft të qarta në Njoftim të cilat do t'i lejonin Mbrojtjes të vlerësonte rëndësinë materiale që ato kanë për përgatitjet e saj.

Rëndësinë Materiale të Informacionit të Kërkuar sipas Rregullës 102(3) dhe Çështje të Lidhura me të ("Vendimi mbi Rëndësinë Materiale në Çështjen 07"), 1 prill 2021, publik, para. 22.

²⁹ Vendim mbi Apelin e Nxjerrjes së Materialit, para. 38, 44. *Shih gjithashtu, Vendim mbi Rëndësinë Materiale në Çështjen 07, para. 23.*

³⁰ Vendim mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Provave , para. 39, 45.

³¹ Vendim mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Provave , para. 46.

20. Në zbatimin e këtyre parimeve në çështjen aktuale, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Njoftimi përmban 68.753 dokumente, që është një numër mjaft i madh. Ndonëse shumica e dokumenteve janë të përshkruara gjerësisht, ka disa të tjera që u mungojë hollësi të tilla dhe përshkruhen me fjalë më të përgjithshme. Për ilustrim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se përshkrimet e disa prej dokumenteve në Njoftim përmbajnë referenca të qarta ndaj një të akuzuari të caktuar,³² i referohen plotësisht një personi apo ngjarjeje të caktuar,³³ apo shkurtimisht shpjegojnë përmbajtjen e një dokumenti,³⁴ duke i mundësuar kështu Mbrojtjes të kuptojë rëndësinë e tyre dhe të kryejë një vlerësim paraprak të rëndësisë materiale të tyre për përgatitjet e veta. Nga ana tjetër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se përshkrimet e dokumenteve të cilat i referohen shkurt dhe qartë deklaratës me datë të një dëshmitari,³⁵ një bisede telefonike,³⁶ një fotografie,³⁷ një shënimi,³⁸ pa iu referuar përmbajtjes së tij qoftë dhe në mënyrë të përgjithshme, janë tepër të mjegullt. Gjykatësi i Procedurës Paraprake pajtohet me Mbrojtjen dhe e kupton se në raste të tilla, Mbrojtja në fakt nuk mund të kuptojë rëndësinë e këtyre dokumenteve për çështjen dhe, rrjedhimisht, të vlerësojë rëndësinë materiale të tyre për përgatitjet e saj.

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se ZPS-ja ka marrë përsipër ta shqyrtojë më tej Njoftimin, në veçanti në lidhje me dokumentet e përmendura nga Mbrojtja, dhe se një shqyrtim i tillë ndërkohë është duke u bërë. Duke kujtuar se merret si i mirëqenë fakti se ZPS-ja i përmbush me ndershmëri detyrimet e saj për

³² *Shih, për shembull*, F00421/A01, dokumentet 64622-65047, f. 2758-2777. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se kjo dhe listat vijuese nuk janë shteruese dhe janë dhënë vetëm si shembuj.

³³ *Shih, për shembull*, F00421/A01, dokumentet 1503-1520, f. 54.

³⁴ *Shih, për shembull*, F00421/A01, dokumenti 1559, f. 55.

³⁵ *Shih, për shembull*, F00421/A01, dokumentet 2-172, f. 2-5; dokumentet 174-212, f. 5-6; dokumentet 358-363, f.13; dokumentet 555 to 559, f. 22.

³⁶ *Shih për shembull*, F00421/A01, dokumentet 18141-18173, f. 755-756; dokumentet 18175-18384, f. 756-765.

³⁷ *Shih, për shembull*, F00421/A01, dokumenti 22423, f. 931.

³⁸ *Shih, për shembull*, F00421/A01, dokumenti 4350, f. 150.

nxjerrje materiali,³⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon që një shqyrtim i tillë duhet të trajtojë shqetësimet e Mbrojtjes për sa i takon Njoftimit.

22. Duke marrë parasysh faktin që (i) disa dokumente të Njoftimit përshkruhen mjaftueshëm dhe i mundësojnë Mbrojtjes të vlerësojë rëndësinë e tyre materiale; (ii) shqyrtimi i mëtejshëm nga ZPS-ja është aktualisht duke u bërë për të trajtuar shqetësimet e vëna në dukje nga Mbrojtja, dhe faktin që; (iii) ZPS-ja nuk ka nevojë të shpjegojë me hollësi rëndësinë e secilit prej dokumenteve, por se duhet të japë një përshkrim të hollësishëm të tyre, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e sheh të nevojshme ta urdhërojë ZPS-në të shtojë një fushë tjetër në Njoftimin e saj, sikundër kërkohet nga Mbrojtja. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrjedhimisht e hedh poshtë Kërkesën e Mbrojtjes për sa i takon shtimit të një fushe tjetër në Njoftim.

23. Megjithatë, pasi është pajtuar me pretendimin e Mbrojtjes se disa prej dokumenteve në Njoftim kanë nevojë për specifikime të mëtejshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të nevojshme të udhëzojë palët që ta zgjidhin këtë çështje së pari *inter partes* dhe ta mbajnë atë të informuar për zhvillimet. Në këtë drejtim, ai kujton se Mbrojtja duhet të njoftojë ZPS-në deri të premtën, 24 shtator 2021,⁴⁰ ose në çdo kohë më parë, për dokumentet (që janë mjaftueshëm të hollësishme në Njoftim) lidhur me të cilët ajo kërkon të ketë qasje përmes nxjerrjes apo këqyrjes së tyre.⁴¹ Brenda të njëjtit afat, apo në çdo kohë më parë, Mbrojtja duhet t'i bëjë të ditur ZPS-së dokumentet për të cilat nevojiten hollësi të mëtejshme, përveç atyre të bëra të njohura në parashtrimet e saj sipas standardeve

³⁹ Vendim mbi Apelet lidhur me Nxjerrjen e Provave , para. 53, me referenca të mëtejshme.

⁴⁰ Vendim mbi Zgjatjen e Afatit, para. 16(c).

⁴¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton se, rrjedhimisht afatet e vendosura në Vendimin mbi Zgjatjen e Afatit, para. 16(c)-(e) vazhdojnë të zbatohen në lidhje me këto dokumente. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej, në këtë drejtim, se Mbrojtja ndërkohë po i parashtron ZPS-së disa kërkesa për material: *shih për shembull* KSC-BC-2020-06, F00444, Mbrojtja e z. Veseli, *Njoftimi nga Mbrojtja e Veselit të Kërkesës për Qasje në Materiale sipas Rregullës 102(3)*, 26 gusht 2021, publik, me Shtojcën konfidenciale 1; F00459, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Njoftimi i Parë nga Mbrojtja e Krasniqit të Kërkesës për Qasje në Materiale sipas Rregullës 102(3)*, 7 shtator 2021, publik, me Shtojcën konfidenciale 1.

të përcaktuara në paragrafët 19-20 më lart. ZPS-ja ia jep Mbrojtjes informacionin e kërkuar në bazë *inter partes* dhe brenda dy javësh nga çdo kërkesë e Mbrojtjes, apo në çdo kohë më parë. Gjithashtu, me marrjen e të gjitha kërkesave të Mbrojtjes, ZPS-ja përgatit një Njoftim të ndryshuar i cili përmban përshkrime më konkrete, sikundër kërkohet nga Mbrojtja ose siç jepet *proprio motu* nga ZPS-ja deri të premten, 22 tetor 2021 dhe e dorëzon të protokolluar në dokumentacionin e çështjes. Për të lehtësuar punën e Mbrojtjes për identifikimin e dokumenteve përshkrimet e të cilëve janë përditësuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në t'i theksojë dokumentet e përditësuar në Njoftimin e ndryshuar ose me një kod ngjyre, ose me germa me ngjyrë.

24. Lidhur me dokumentet për të cilat do të kërkohen apo bëhen ndryshime në përshkrime, Mbrojtja duhet t'i bëjë të ditur ZPS-së deri të premten, 5 nëntor 2021, ose në çdo kohë më parë, se në cilat dokumente kërkon të ketë qasje përmes nxjerrjes apo këqyrjes së tyre. Në bazë të një njoftimi të tillë, jo më vonë se të premten, 26 nëntor 2021, ose brenda tri javësh nga njoftimi (njoftimet) i Mbrojtjes, në cilëndo datë të mëhershme, ZPS-ja duhet : (i) të nxjerrë apo të sigurojë qasje në materialin e zgjedhur që nuk kërkon redaktime; dhe (ii) të bëjë një kërkesë për masa mbrojtëse, nëse kërkohen, lidhur me materialin e kërkuar nga Mbrojtja. ZPS-ja i nxjerr Mbrojtjes materialin për të cilin janë miratuar redaktimet sa më shpejt që të jetë e mundur pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi masat e kërkuara mbrojtëse. Në rast se ZPS-ja dëshiron të kundërshtojë rëndësinë materiale të provave të kërkuara nga Mbrojtja, ajo duhet t'i drejtohet Trupit Gjykses brenda 10 ditësh nga njoftimi i Mbrojtjes.

25. Duke pasur parasysh nevojën për të siguruar rakordim të afateve për dorëzimin e parashtrimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake *proprio motu* i miraton të njëjtën zgjatje afati Rexhep Selimit ("Z. Selimi"), në rast se ai ka dëshirë ta njoftojë ZPS-në për ndonjë dokument për të cilin nevojiten hollësi të mëtejshme sipas standardeve të përcaktuara në paragrafët 19-20 më lart.

VI. RIKLASIFIKIMI

26. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Kërkesa për Bashkim e Thaçit është dorëzuar si konfidenciale. Duke mos gjetur asnjë arsye për ruajtjen e klasifikimit konfidencial dhe në mungesë të përmbajtjes së ndonjë informacioni konfidencial në të, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrjedhimisht e udhëzon Zyrën Administrative të riklasifikojë F00431 si publik.

VII. VENDIMI

27. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **REFUZON** Kërkesën e Mbrojtjes lidhur me shtimin e një fushe tjetër në Njoftim;
- b) **KUJTON** se, në bazë të Vendimit mbi Zgjatjen e Afatit, Mbrojtja duhet ta njoftojë ZPS-në deri të **premtën, 24 shtator 2021**, apo në çdo kohë më parë, për dokumentet (të cilat janë mjaftueshëm të hollësishme në Njoftim) tek të cilat ajo kërkon të ketë qasje përmes nxjerrjes apo këqyrjes së materialit dhe se afati i përcaktuar në paragrafin 16(c)-(e) të Vendimit mbi Zgjatjen e Afatit, do të vijojë të zbatohet në lidhje me këto dokumente;
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen t'i bëjë të ditur ZPS-së dokumentet për të cilat nevojiten hollësi të mëtejshme, në bazë të standardeve të përcaktuara në paragrafët 19-20 më lart deri të **premtën, 24 shtator 2021**, ose në çdo kohë më parë;
- d) **URDHËRON** ZPS-në t'i japë informacionin e kërkuar Mbrojtjes në bazë *inter partes*, **brenda dy javësh të çdo kërkesë të Mbrojtjes për informacion**, ose në çdo kohë më parë;
- e) **URDHËRON** ZPS-në të përgatisë një Njoftim të ndryshuar i cili të përmbajë një përshkrim më konkret, sikundër kërkohet nga Mbrojtja ose sikurse jepet *proprio motu* nga ZPS-ja deri të **premtën, 22 tetor 2021** dhe ta protokollojë atë në dokumentacionin e çështjes dhe të theksojë në Njoftimin e ndryshuar ose me një kod ngjyre ose me germa me ngjyrë, dokumentet e përditësuara;
- f) **URDHËRON** Mbrojtjen të njoftojë ZPS-në deri të **premtën, 5 nëntor 2021**, se në cilët dokumente midis atyre të kërkuara në

paragrafin c) më lart ajo kërkon të ketë qasje përmes nxjerrjes apo këqyrjes;

- g) **URDHËRON** ZPS-në, deri jo më vonë se **të premten, 26 nëntor 2021**, ose brenda tri javësh nga njoftimi (njoftimet) e Mbrojtjes, cilado qoftë më parë, të: (i) nxjerrë apo t'i japë qasje asaj në materialin e zgjedhur që nuk kërkon redaktime; dhe (ii) të dorëzojë një kërkesë për masa mbrojtëse, nëse ka nevojë, lidhur me materialin e kërkuar nga Mbrojtja;
- h) **URDHËRON** ZPS-në t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake **brenda dhjetë ditësh nga njoftimi (njoftimet) e Mbrojtjes** në rast të lindjes së ndonjë mosmarrëveshjeje lidhur me rëndësinë materiale të provave; dhe
- i) **URDHËRON** Zyrën Administrative ta riklasifikojë F00431 si publik.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 8 shtator 2021

Hagë, Holandë.